



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr.3360/51 Regjistri Themeltar

Nr.9 Vendimi

Datë 30.04.2014 regjistrim

Datë 19.01.2015

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga gjyqtarët:

GJYQTARE : Altina NASUFI

GJYQTARE : Alkelina GAZIDEDJA

GJYQTARE: Blerona HASA

asistuar nga sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, në Tiranë në datë 19.01.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, çështjen administrative me nr.3360/51 regjistri themeltar, datë 30.04.2014 regjistrimi, me palë ndërgjyqëse:

PADITËS: Altin Shkurti, i biri i Përparimit dhe i Lumturies, i datëlindjes 06.11.1971, lindur dhe banues në Tiranë, Rruga “Zef Jubani”, pallati “Bjorn”, ap.65, në mungesë.

I PADITUR : Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në mungesë.
Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në mungesë.

OBJEKTI : Konstatimin e pavleshmërisë së aktit administrativ të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.1203/3 prot., datë 18.10.2013 dhe shfuqizimin/anullimin e tij. Urdhërimin e të paditurve të heqin aktin administrativ nr.1203/3 prot., datë

18.10.2013 nga dosja e vlerësimit të gjyqtarit, mospërdorimin e tij për vlerësimin profesional dhe etik të tij dhe mosmarrjen e tij në konsideratë në rast përsëritje në të ardhmen.

BAZA LIGJORE : Neni 42, 145, 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i KEDNJ-së, nenet 93, 116, 117, 118 e vijues, 135 e vijues, 146/b të Kodit të Proçedurave Administrative, Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 8811, datë 17. 05. 2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 911, datë 07.03.2014 ka vendosur :

- Rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen paditësit.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nr.911, datë 07.03.2014 ka paraqitur ankim paditësi Altin Shkurti duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë:

- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë analizon drejt kur e quan aktin juridik nr. 1203/3 prot datë 18. 10. 2013 akt administrativ individual, por gabon kur konkludon se ky akt është një akt administrativ i ligjshëm dhe e rrëzon me pa të drejtë padinë.
- Konkluzioni i Gjykatës se “ tërheqja e vëmëndjës me shkrim” nuk është masë disiplinore por një “konkluzion” vjen në kundërshtim me vetë përkufizimet e dhëna në nenin 105 të K. Pr. Administrative dhe me nenin 2/1/2 të ligjit nr. 49/2012. Nga këto dy përcaktime të dhëna nga ligjvënësi vetkuptohet se akti administrativ nuk mund të jetë një “konkluzion”. Pra akti administrativ nuk mund të jetë një konkluzion, por një vullnet i shprehur i një organi publik që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.
- Konkuzioni i Gjykatës bie në kundërshtim me vetë përmbajtjen e aktit administrativ. Nga përmbajtja e tij nxirret se është konstatuar “shkelje”, për kryerjen e së cilës “tërhiqet

vëmendja” dhe ky akt do të jetë pjesë e dosjes së vlerësimit etik dhe profesional dhe rezultatet e këtij verifikimi do të mbahen në konsideratë në rastë përsëritje në të ardhmen. Pra sipas përmbajtjes së aktit kemi të bëjmë me konstatimin e një shkeljeje dhe për këtë shkelje jepet masa disiplinore “tërheqje vëmendjes me shkrim” dhe konkluzioni i gjykatës se kemi të bëjmë me një “komunikim” të konkluzionit të inspektimit është i gabuar dhe në kundërshtim me vetë vendimin e saj që pranon se kemi të bëjmë me akt administrativ. Nëse “tërheqja e vëmendjes me shkrim” nuk është masë disiplinore atëherë ç’farë është?

- Gjykata nuk ka arritur një konkluzion të bazuar teksa ka arsyetuar se i padituri që ka nxjerrë një akt administrativ nuk ka ushtruar një kompetencë tej atyre që ligji i ka njohur.
- Akti administrativ nr. 1203/3 prot. datë 18.10.2013 është një akt i kundërligjshëm për të gjitha argumentat juridike të paraqitura në kërkesë padi. Gjykata nuk ka analizuar asnjë prej pretendimeve të paraqitura në kërkesë padi për antikushtetueshmërinë e aktit dhe kundërligjshmërinë e tij.
- Akti administrativ nr.1203/3 Prot. datë 18.10.2013 i KLD-së nxjerrë nga Zëvendëskryetari i tij është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin për këto arsye:
- Nga vetë rëndësia që ka pushteti gjyqësor rregullimet themelore bëhen në pjesën e nëntë të Kushtetutës (nenet 135-147). Akti administrativ nr. 1203/3 Prot.datë 18.10.2013 vjen në kundërshtim me nenin 147 dhe 4 të Kushtetutës. Këto parashikime të kompetencave të tij janë në mënyrë shteruese dhe për rrjedhojë Zëvendëskryetari nuk mund të kryejë detyrë tjetër përveç atyre të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj dhe sipas këtyre referencave ai nuk ka kompetencë ligjore të nxjerrë akte administrative për tërheqje vëmendje me shkrim ndaj gjyqtarëve.
- Në bazë të nenit 147 të Kushtetutës është KLD që vendos për transferimin e gjyqtarëve dhe përgjegjësinë disiplinore ndaj tyre. Kjo e fundit parashikohet në nenin 31 deri në nenin 36 të ligjit nr.9877. datë 18.02.2008. Neni 33 i këtij ligji parashikon edhe llojet e masave disiplinore që jepen ndaj gjyqtarëve. Verifikimi i shkeljeve kryhet nga Inspektoriati i KLD-së dhe detyrat e tij përcaktohen në ligji nr. 8811. datë 17. 05. 2001 në nenin 16 pika "b" dhe "c" të tij. Verifikimi kryhet vetëm pasi gjyqtari të jetë vënë në dijeni paraprakisht. Inspektoriati verifikon ankesat që mund të përbëjnë shkak ligjor për procedim disiplinor. Nëse vërehet se ekzistojnë shkaqe të tilla atëherë i përcillet një

relacion shpjegues nëpërmjet Zëvendëskryetarit të KLD-së menjëherë Ministrin të Drejtësisë për të gjykuar për procedim disiplinor.

- Sipas nenit 34 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 është Ministri i Drejtësisë që ka të drejtë të nisë procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit në KLD. Nga përmbajtja e kësaj dispozite kushtetuese kuptohet se Rregullorja "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë", vlen për normimin e punës së Inspektoriatit dhe jo për të përcaktuar masa disiplinore të tjera përveç atyre të përcaktuara në ligj.
- Rregullorja "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë", ka përcaktuar një shkelje që nuk përcaktohet si e tillë në ligj dhe sipas përmbajtjes së nenit 34 të Rregullores nuk është thellësisht e tillë sa të iniciohet përshtatshëm një procedim disiplinor ndaj gjyqtarit për dhënien e masave disiplinore të përcaktuara në nenet 31 deri 33 të ligjit nr. 9877, datë 18. 02. 2008. atëherë për këtë shkelje, ndaj gjyqtarit merret një masë disiplinore që emërtohet në rregullore "tërheqje vëmendje me shkrim". duke u bërë kjo masë pjesë e dosjes së vlerësimit profesional dhe etik të tij. Ndërkohë që në aktin administrativ objekt gjykimi përcaktohet se kjo shkelje do të mbahet në konsideratë në rast përsëritje në të ardhmen. Kjo e bën rregulloren të jetë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin.
- Nëse krahasojmë përmbajtjen e nenit 33/3, 4, 5 të ligjit nr. 9877, datë 18. 02. 2008 me atë të nenit 34/2 të Rregullores do të vëmë re se terminologjia e përdorur është identike. Në të dyja këto nene pikënisja është e njëjtë, konstatimi i shkeljeve të kryera nga gjyqtari dhe për këtë fakt konkludohet në dhënien e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve.
- Në rast se nuk konstatohet shkelje ligjore, por një shkelje sipas konkludimit të Inspektoriatit ndaj gjyqtarit aplikohet masa disiplinore e përcaktuar në nenin 34/2 të Rregullores "Tërheqje e vëmendjes me shkrim". Nga kjo analizë rezulton se është parashikuar një masë e re disiplinore në nenin 34/2 të Rregullores jashtë atyre të parashikuara në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008.
- Ndërmjet këtyre masave ka vetëm një dallim, që neni 31/2 dhe 34/2, 3, 4, 5 të ligjit nr. 9877, datë 18. 02. 2008 kemi të bëjmë me dhënien e masave disiplinore për shkelje të ligjit. Ndërsa në nenin 34/2 të Rregullores nuk kemi të bëjmë me shkelje të ligjit, por me dhënien e masave disiplinore për shkelje që çmohen nga Inspektoriatit në mënyrë subjektive pasi nuk asnjë kriter që ta normojë këtë konstatim.

- Tërheqja e vëmendjes me shkrim është masë disiplinore "*sui generis*", e paparashikuar në ligjin nr. 9877, datë 18. 02. 2008. si e tillë ajo nuk i nënshtrohet efekteve të shlyerjes së masave disiplinore të dhënë në nenin 33/6 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008. Për rrjedhojë tërheqja e vëmendjes me shkrim, vazhdon të qëndrojë në dosjen personale të gjyqtarit edhe pas kalimit të afatit 3 vjeçar të parashikuar në ligjin nr. 9877, datë 18.02. 2008, pasi në Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë", nuk është parashikuar ndonjë afat për shlyerjen e saj.
- Konkluzioni i gjykatës se akti administrativ nr. 1203/3 prot, datë 18.10.2013 i KLD-së nxjerrë nga Zëvendëskryetari nuk është masë disiplinore dhe se Zëvendëskryetari nuk është në tejkalim të kompetencave të tij është alogjik dhe në kundërshtim me ligjin. Gjykata pavarësisht faktit se veprimtaria e tij nuk është në tejkalim të kompetencës, nuk përcakton se cila është dispozita ligjore që i jep të drejtë Zëvendëskryetarit që t'i tërheqë vëmendjen me shkrim gjyqtarit, për shkelje që çmohen nga organi por nuk parashikohen në ligj. Në këto rrethana akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk mund të sjellë pasoja juridike. Gjykata duke i dhënë aktit administrativ legjitimitet nuk bënë gjë tjetër vetëm shkel Kushtetutën(neni 145) dhe ligjin. Veprimtaria e Zëvendëskryetarit nuk mund të mështetet në Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë", për shkak të qenies të këtij parashikimi në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin.
- Inspektimi i çështjes së përfunduar me vendimin nr. 7458, datë 01. 07. 2013 është kryer nga Inspektoriatit në kundërshtim me nenin 16/1 gërma "a" të ligjit nr. 8811, datë 17.05. 2013 ku inspektori verifikon vetëm ankesat të cilat nuk mund të zgjidhen me anë të apelimit gjyqësor. Kështu çështja objekt gjykimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe kjo vërtetohet në sekretarinë gjyqësore datë 30.10.2013. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 2531, datë 21.11.2013 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 7458, datë 01.07.2013. Kjo gjykatë nuk ka vënë re shkelje të afatit në gjykimin e çështjes. Të gjitha pretendimet e palëve janë shqyrtuar në vendimin e Gjykatës së Apelit por nuk është vënë re shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në këto rrethana nuk duhej të ishte bërë inspektimi sipas nenit 16/1 gërma "a" të ligjit nr. 8811, datë 17. 05. 2013.

- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka argumentuar se nuk e gjen të mbështetur pretendimin e paditësi se akti administrativ nr. 1203/3 Prot.datë 18. 10. 2013 është nxjerrë në kundërshtim me Kodin e Proçedurës Administrative pasi ky akt është përmbyllje e një procesi të nisur nga një person i interesuar dhe që ka vijuar nga ana e Inspektoriatit dhe që paditësi ka marrë dijeni me shkesën datë 01. 07. 2013 të nënshkruar prej tij. Gjithashtu paditësi ka marrë dijeni dhe për përfundimin e inspektimit me shkresën nr.1203/3 prot datë 18.10.2013 të cilën e ka ankimuar administrativisht. Gjithashtu sipas gjykatës nuk ka as shkelje proçedurale që paditësit t'i jetë mohur ndonjë e drejtë. Ky konkluzion i gjykatës është alogjik sepse akti administrativ nr. 1203/3 prot datë 18. 10. 2013 është nxjerrë në kundërshtim me proçedurën e përcaktuar në nenin 93 të K. Pr. Am.
- Paditësi si person i interesuar është vënë në dijeni për aktin administrativ vetëm sipas faktit që në bazë të ankesës çështja civile e përfunduar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 7485, datë 01. 07. 2013 i është nënshtruar verifikimit të Inspektoriatit të KLD-së. Në vijim të kësaj proçedure është komunikuar akti administrativ nr.1203/3 prot. datë 18.10.2013 i Zëvendëskryetarit të KLD-së. Duke mos qenë i informuar për përfundimin e proçesit të verifikimit të Inspektorit nuk më është dhënë mundësia të jap argumentat e mia për konkluzionin e arritur nga Inspektori. Kjo çënon nenin 93 dhe 116/c të Kodit të Proçedurave Administrative dhe për rrjedhojë është akti objekt gjykimi është absolutisht i pavleshëm sepse nuk është respektuar proçedura e nxjerrjes së tij. E drejta e mbrojtjes është e garantuar në nenin 35 të ligjit nr. 9877, datë 18. 02. 2008 për gjyqtarin ndaj të cilit merret masa disiplinore.
- Për sa më sipër kërkoj në bazë të nenit 466/b të Kodit të Proçedurës Civile dhe nenit 55/c të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nr. 911, datë 07. 03. 2014 dhe pranimin e kërkesë padisë si të bazuar në ligj dhe në prova.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

në mungesë të palëve ndërgjyqëse, pasi shqyrtoi të gjitha aktet shkresore dhe bisedoi çështjen në tërësi.

V Ë R E N

1. Rrethanat e çështjes:

Paditësi Altin Shkurti ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij gjyqësore dhe konkretisht gjykimit të çështjes civile me nr.17375, datë regjistrimi 20.12.2011 me paditës Alaska Topulli, të paditur Gani Zylfo, Liri Zylfo etj, në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë(*në tekstin vijues KLD*) është paraqitur një ankesë ndaj tij për zvarritje të gjykimit dhe njëanshmëri në gjykim. Konkretisht, shtetasja Alaska Topulli me ankesën e saj protokolluar në KLD me nr.1203 prot., datë 18.04.2013 ka pretenduar se ka filluar që në vitin 2011 nje proces gjyqësor. çështje e cila po gjykohej nga gjyqtari Altin Shkurti, i cili sipas saj po zvarriste palëndësisht shpalljen e vendimit edhe pse ishin zhvilluar mbi 15 seanca gjyqësore.

Kjo ankesë, bazuar ne nenin 27 të Rregullores “*Për funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë*”, i është nënshtruar shqyrtimit paraprak, ku me relacionin e datës 13.05.2013 të hartuar nga Inspektorati dhe të miratuar prej Zëvendëskryetarit, është konkluduar se përmbante shkaqe për verifikimin e ankesës lidhur me pretendimin e zvarritjes së gjykimit. Në relacionin e shqyrtimit paraprak është argumentuar fakti se kjo çështje civile, megjithëse kishte filluar që në vitin 2011, nuk kishte përfunduar ende së gjykuari, duke qënë në kapërcim të kufijve kohorë të përcaktuara në Aneksin nr 1 “*Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore*”, të vendimit nr.261/2 datë 14.04.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “*Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve*”. Ne vijim, nga ana e Kryeinspektores së Inspektoratit te KLD-së është nxjerrë Urdhri i Verifikimit të kësaj ankese nr.1203/1 prot., datë 28.06.2013. Bazuar në këtë urdhër, nga ana e dy inspektorëve të ngarkuar për kryerjen e verifikimit, është njoftuar gjyqtari Altin Shkurti mbi veprimet që do të kryheshin, si dhe dosjen që do te verifikohej, konform nenit 30 pika 2 te Rregullores se Inspektoratit. Njoftimi është dokumentuar me shkrim me aktin e njoftimit datë 01.07.2013, i nënshkruar rregullisht nga ana e gjyqtarit, inspektorëve dhe kryetarit te gjykatës.

Në përfundim të inspektimit të kryer, është konkluduar se gjyqtari Altin Shkurti, ka lejuar zvarritje të procesit gjyqësor me pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve dhe konkretisht realizimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor. Kjo zvarritje është konsideruar si e pamjaftueshme për t'u vlerësuar si shkelje disiplinore, pasi nuk janë plotësuar kërkesat e nenit 32 pika 3, germa "a" të ligjit nr.9877 date 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Kjo parregullsi e konstatuar lidhur me zvarritjen e gjykimit prej gjyqtarit Altin Shkurti, është konsideruar e mjaftueshme që në bazë të nenit 34/2 të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së" t'i tërhiqet vëmendja me shkrim gjyqtarit.

Tërheqja e vëmendjes me shkrim i është komunikuar gjyqtarit Altin Shkurti në datë 28.10.2013, me shkresën nr.1203/3 prot. Me aktin nr.1203/6 prot., datë 20.11.2013 gjyqtari Altin Shkurti i është drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Zëvendëskryetarit të KLD-së, duke kundërshtuar aktin administrativ nr.1203/3, datë 18.10.2013 duke kërkuar shfuqizimin e tij si absolutisht të pavlefshëm. Me shkresën nr 1203/7 prot., date 06.12.2013 i është kthye përgjigja perkatese ku i janë shpjeguar dhe arsyet ligjore të tërheqjes së vëmendjes me shkrim ndaj tij.

Në datën 06.01.2014 paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt: Konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.1203/3 prot, datë 18.10.2013 dhe shfuqizimin/anullimin e tij. Urdhërimin e të paditurve të heqin aktin administrativ nr.1203/3 prot, datë 18.10.2013 nga dosja e vlerësimit të gjyqtarit dhe mospërdorimin e tij për vlerësimin profesional dhe etim të tij. Në seancën përgatitore të datës 21.02.2014 paditësi ka kërkuar saktësimin e ndërgjyqësisë lidhur më të paditurin Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjykata e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën e tij. Në seancën gjyqësore datë 07. 03. 2014 paditësi ka kërkuar shtimin e objektit të padisë lidhur me kërkimin tjetër mosmarrjen e aktit administrativ në konsideratë në rast përsëritje në të ardhmen. Gjykata e Shkallës së Parë ka pranuar këtë kërkesë të paditësit në kushtet e nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile.

II. Pretendimet dhe prapsimet e palëve ndërgjyqëse në proces gjyqësor:

Pretendimet e paditësit:

Paditësi ka pretenduar pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr.1203/3 prot. datë 18.10.2013 duke parashtruar këto argumente:

Ky akt është nxjerrë nga Zëvendëskryetari në kapërcim të kompetencave të tij të përcaktuara në nenin 147/3 të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Tërheqja e vëmëndjes më shkrim përbën një masë disiplinore që nuk parashikohet nga nenet 31-33 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Dhënia e masave disiplinore nuk është kompetencë e Zëvendëskryetarit por e vetë KLD-së.

Kompetencat e Zëvendëskryetarit të KLD –së përmenden në nenin 147 të Kushtetutës dhe në nenet 12 dhe 13 të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, ndaj Zëvendëskryetari i KLD-së nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë tjetër tej atyre të parashikuara me ligj. Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të KLD-së” që i ka shtuar këtë kompetencë Zëvendëskryetarit vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin. Kjo për shkak sepse është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e kërkuar për nxjerrjen e aktit administrativ. Paditësi nuk është informuar për përfundimin e verifikimit të inspektorit dhe nuk i është dhënë mundësia për të shprehur argumentat për këtë verifikim. Për rrjedhojë akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm sipas nenit 116/c të Kodit të Procedurave Administrative.

Paditësi ka kërkuar edhe shfuqizimin ose anulimin e këtij akti, duke qënë se përmbajtja e tij bie në kundërshtim me ligjin. Çështja gjyqësore objekt inspektimi ka qënë një çështje e ndërlikuar, shto këtu edhe ngarkesën e lartë të punës të përballuar nga paditësi, prandaj është gjykuar brenda një afati të arsyeshëm kohor sipas praktikës gjyqësore shqiptare dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së. Çështja gjyqësore objekt inspektimi është nënshtruar edhe kontrollit gjyqësor nga një gjykatë e lartë dhe nuk është gjetur asnjë shkelje ligjore. Përcaktimi se gjykimi i një çështje është bërë brenda një afati të arsyeshëm është kompetencë gjyqësore, e cila përfshin në gjykim edhe shumë kritere të tjera përveç faktorit kohë. Për këtë arsye vendimi i KLD-së nr.261/2, datë 14.04.2010 që përcakton kriterin kohë si një nga kriteret matëse të veprimtarisë së gjyqtarëve, nuk mund të

përdoret apriori për të konkluduar se është shkelur standarti kushtetues i parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Tërheqja e vëmendjes me shkrim përbën një masë disiplinore "sui generis" që nuk i nënshtrohet afateve të parashkrimit sikundër ndodh me masat disiplinore të parashikara nga neni 36 i ligjit nr. 9877, datë 18. 02. 2008. Për më tepër paditësi ndëshkohet dy herë për të njëjtën çështje: një herë për shkak të aktit administrativ dhe një herë kur të llogaritet kjo çështje në numërin e të gjykuara jashtë afatit.

Prapësimet e palës së paditur:

Pretendimet e paditësit janë haptazi të pabazuara. Inspektimi është bërë nisur nga ankesa e palës së interesuar në bazë të nenit 24/1. të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë" si dhe duke mbajtur parasysh vendimin nr. 49, datë 30. 04. 2001 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin nr. 7/2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Çështja gjyqësore objekt gjykimi është realizuar nga paditësi për një vit, gjashtë muaj e dhjetë ditë tej afatit të përcaktuar në nenin 5/c të vendimit nr. 261/2 datë 14.04. 2010 të KLD-së. Ka patur një mosorganizim të mirë të punës dhe paditësi nuk i ka përdorur mirë të gjitha mjetet proceduriale për gjykimin e çështjes brenda afatit. Por duke mos e konsideruar rastin të mjaftueshëm për përgjegjësi disiplinore është konkluduar në tërheqjen e vëmendjes me shkrim duke e bërë këtë akt edhe pjesë të dosjes së vlerësimit profesional dhe etik të tij. Kjo është parashikuar në nenin 16, shkronjart "d" dhe "dh" të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001, nenit 34/2 të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të KLD-së" dhe nenit 23/1/d të vendimit nr. 261/2 datë 14. 04. 2010 të KLD-së. Paditësi ka marrë dijeni rregullisht nëpërmjet shkresës për tërheqje vëmendjeje të përcjellë nga Zëvendëskryetari i KLD-së në ushtrim të kompetencave të tij sipas nenit 13/2 pika " a" dhe "b", 34/3 të ligjit nr. 8811, datë 17. 05. 2001.

III. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë:

Gjykata në vlerësimin e saj për pretendimet dhe prapësimet e palëve mban parasysh Kushtetutën, ligjin nr. nr. 9877, datë 18. 02. 2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligji nr. 8811, datë 17. 05. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë".

Sipas nenit 7 të Kushtetutës sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin e pushteteve. Neni 147 dhe neni 135 i Kushtetutës shprehen për KLD-, Zëvendëskryetarin dhe pushtetin gjyqësor. Kompetencat e Zëvendëskryetarit paraqiten në nenin 147 të Kushtetutës dhe mënyra e ushtrimit të tyre rregullohet në ligjin nr. 8811, datë 17. 05. 2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” dhe Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të KLD-së”. Ky i fundit është në varësi të KLD-së dhe mbledh të dhëna për veprimtarinë e gjyqtarëve dhe konstaton nëse ka shkelje që mund të fillojë procedimi disiplinor.

Në rastin konkret Inspektoriatit ka filluar inspektimin nisur nga ankesa për gjyqtarin Altin Shkurti. Në përfundim të verifikimit është konstatuar se nuk ka shkelje që çojnë në masë disiplinore por duhet vetëm tërheqje vëmendje me shkrim. Kjo e fundit është përcjellë nga Zëvendëskryetari në zbatim të nenit 34/3 të Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të KLD-së”.

Gjykata analizon se “tërheqja e vëmendjes me shkrim”, nuk është masë disiplinore por një konkluzion i inspektimit të bërë nga Inspektoriatit të KLD-së për një çështje të caktuar. Përcjellja e këtij konkluzioni nga ana e Zëvendëskryetarit të KLD-së nuk duhet kuptuar si një masë disiplinore që merret ndaj gjyqtarit, por si një komunikim i konkluzionit të inspektimit të kryer më parë. Për pasojë Gjykata konkludon se i padituri Zëvendëskryetari i KLD-së teksa ka nxjerrë aktin administrativ nr 1203/3 prot datë 18.10.2013, nuk ka ushtruar një kompetencë tej asaj që i ka dhënë ligji dhe as ka caktuar një masë disiplinore ndaj paditësit Altin Shkurti.

Lidhur me pretendimin e paditësit se nuk është respektuar procedura e nxjerrjes së aktit administrativ sipas Kodit të Procedurave Administrative, Gjykata nuk e gjen të mbështetur në ligj këtë pretendim sepse ky akt është përmblyllje e një procesi të nisur nga një person i interesuar dhe që ka vijuar nga ana e Inspektoriatit akt për të cilin paditësi ka marrë dijeni me shkesën datë 01.07.2013 të nënshkruar prej tij. Gjithashtu paditësi ka marrë dijeni dhe për përfundimin e inspektimit me shkresën nr.1203/3 prot., datë 18.10.2013 të cilën e ka ankimuar administrativisht dhe gjyqësisht. Pra nuk ka asnjë shkelje procedurale që t'i ketë mohuar paditësit një të drejtë

thelbësore të tij, kushtetuese apo ligjore. Lidhur me pretendim se përmbajtja e aktit administrativ është në kundërshtim me ligjin, Gjykata vlerëson se nuk ka asnjë dispozitë ligjore që të jetë shkelur nga akti administrativ. Në përfundim Gjykata vlerëson se akti administrativ nr.1203/3 prot datë 18.10.2013 i nxjerr nga KLD-ja nëpërmjet Zëvendëskryetarit është i bazuar në ligj pasi nuk u provua asnjë shkak pavleshmërie absolute apo relative e tij. Për pasojë padia duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj.

IV. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

Në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit. Gjykata Administrative e Apelit konstaton se ankimi është paraqitur konform kërkesave ligjore të neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr.49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”* i ndryshuar, brenda afatit ligjor, në respektim të formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga neni 454 i Kodit të Procedurës Civile, para gjykatës kompetente, jashtë kushteve ndaluese të nenit 45 të ligjit nr.49/2012(vendimet e paankimueshme).

Për të parashtuar një kërkim në gjykim ose për këtë kundërshtuar këtë kërkim është e nevojshme që të ketë interes. Ky interes është dobia personale për të kërkuar me anë të gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejtë të mohuar ose të shkelur. E drejta e një subjekti për të paraqitur një padë para gjykatës që përbën një nga kushtet formale të padisë në gjykimin administrativ, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet që ushtrojnë të drejtën për të ngritur padë para gjykatës administrative, kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe aktit administrativ i cili kundërshtohet si i paligjshëm.

Interesi duhet të jetë aktual, domethënë se dëmi që i shkaktohet paditësit dhe që kërkohet të shmanget me padinë duhet të ketë ngjarë në kohën e ngritjes së padisë ose të vërtetohet në një kohe të ardhme shume të afërt, jo thjesht të ardhme. Që të justifikohet ligjërisht kërkitimi për njohjen njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket sipas ligjës, e drejta e mohuar apo e shkelur prej një të treti (legjitimimi aktiv) dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesit (legjitimimi pasiv) duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e gjykatës për të

ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt ose veprim i të tretit (*legitimitio ad causam*).¹

Në kuptim të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile.:

Padia mund të ngrihet për:

a) të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur:

Edhe sipas nenit 15 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, të drejtën e ngritjes së padisë e ka:

a) çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik:

Miratimi i ligjit nr.49/2012 ka krijuar më shumë hapësirë në kushtet e pranueshmërisë për subjektet që legjitimohen për të ngritur padi në gjykatën administrative. Sipas nenit 15 të ligjit, të drejtën e ngritjes së padisë e ka çdo subjekt që i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik apo për shkak të ndërhyrjeve të paligjshme të organit publik që nuk kanë formën e aktit administrativ. Kuptimin e veprimit administrativ e jep pika 7 e nenit 2 të këtij ligji, sipas së cilës “veprim administrativ” është akti administrativ, kontrata administrative dhe veprimi tjetër administrativ. Në përkulizimet që jep ligji, “akt administrativ” është çdo akt administrativ individual dhe çdo akt nënligjor normativ.²

Në lidhje me interesin për të ngritur padi, në Vendimin Unifikues nr.5, datë 30.10.2012 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë shprehen se:

“Interesi për të ngritur një padi është një element i së drejtës së padisë. Ai dallon nga interesi material për mbrojtjen e të cilit shërben padia. Kjo për arsye sepse janë të dallueshme dy të drejta, ajo materiale dhe ajo procedurale, që ushtrohet për mbrojtjen e së parës. Interesi për të ngritur padi është një interes procedural, dytësor dhe instrumental në lidhje me interesin material dhe ka për objekt masën ose llojin e vendimit që i kërkohet gjykatës si mjet për arritjen e

¹ Procedura Civile, botim i vitit 1962, Alqiviadh Lamani.

² Neni 2, pika 1 e ligjit nr.49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar.

përmbushjes së interesit material i cili është cenuar apo shkelur nga sjellja e palës tjetër ose nga gjendja faktike objektive ekzistuese. Pra, interesi për të ngritur padi lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material dhe për këtë arsye, në esencë, presupozon njohjen e cenimit të një interesi që mund të përmbushet duke kërkuar mbrojtjen në gjykatë. Në këtë vështrim juridik nuk mund të merret në shqyrtim një padi kur në situatën faktike, aktuale, nuk njihet apo nuk evidentohet cenimi i një të drejte ose i një interesi që mund të pretendohet kundrejt palës tjetër. Mungesa e një interesi do të thotë se, nëse ushtrimi i padisë nuk i siguron paditësit asnjë avantazh, gjykata duhet ta deklarojë atë si të papranueshme. Dhe po kështu, nëse mungon apo paditësi nuk arrin të provojë faktin cenues të së drejtës së tij padia është e papranueshme. Paditësi është i detyruar të provojë ekzistencën e disa kushteve ligjore para gjykatës, kushte të cilat lidhen me vetë ekzistencën e interesit të tij të ligjshëm për të ngritur padi. Mbrojtja apo rivendosja e interesit të ligjshëm të pretenduar si të shkelur kërkon ndjekjen e një sërë hapash proceduralë për ta rivendosur. Çdo subjekt që pretendon se i është cenuar një e drejtë ose një interes i ligjshëm, nëpërmjet padisë, objektit dhe shkakut të saj, si dhe gjatë procesit gjyqësor civil, duhet të identifikojë: (i) marrëdhënien juridike nga i burojnë të drejtat apo interesat e ligjshme të shkelura (p.sh. marrëdhënie pronësie, kontraktore, trashëgime, etj.); (ii) personin që e ka cenuar në të drejtën apo interesin legjitim; (iii) faktin që përbën cenimin e të drejtës ose interesit të ligjshëm, veprimet ose mosveprimet e të paditurit të cilat i kanë mohuar/cenuar të drejtën ose interesin e ligjshëm; (iv) të drejtën që synon të realizojë, e cila duhet të jetë konkrete dhe të ketë lindur para ngritjes së kërkesë padisë...³

Në procesin gjyqësor administrativ, subjekti që është mbajtës i të drejtave dhe interesave të ligjshme, për të legjitimuar hyrjen në proces dhe ngritjen e padisë duhet të provojë interesin e ligjshëm në çështjen në shqyrtim. Interesi lidhet me aksesin e paditësit për të kërkuar nëpërmjet gjykatës administrative njohjen ose rivendosjen e një të drejte që garantohet nga ligji e cila rezulton të jetë mohuar ose cënuar nga nga veprimi konkret administrativ. Interesi duhet të jetë aktual, i sigurt dhe i drejtpërdrejtë për paditësin.

Duke patur parasysh këto konsiderata juridike në koneksitet me rrethanat e çështjes, edhe në eventualitetin e konsiderimit të shkresës nr.1203/3 prot, datë 18.10.2013 “*Tërheqje vëmendje*” si

³ Për me gjerë shih Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.5, datë 30.10.2012.

akt administrativ, paditësi nuk provon para gjykatës ekzistencën e interesit aktual në këtë gjykim. Nga padia dhe aktet bashkëlidhur saj, rezulton se në përfundim të verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasja Alaska Topulli, veprimtari të cilën Inspektoriati i KLD-së e ushtron në përputhje me ligjin dhe rregulloren⁴, pasi ka konstatuar shkelje që lidhen me zvarritje të procesit gjyqësor nga ana e gjyqtarit Altin Shkurti, nëpërmjet Zëvendëskryetarit të KLD-së, i cili drejton veprimtarinë e KLD-së⁵, me shkresën “Tërheqje vëmendje” me nr.1203/3 prot, date 18.10.2013, i është tërhequr vëmendja me shkrim duke u bërë ky akt pjesë e dosjes së vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarit Altin Shkurti, sipas përcaktimeve të nenit 16. “d” dhe “dh” të Ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” i ndryshuar si dhe nenit 13/1 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe nenit 23/1/d të Vendimit nr. 261/2 date 14.04.2010 të KLD-së “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarit”.

Referuar përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të mësipërme, “Tërheqja e vëmendjes me shkrim”, shërben për t’u bërë pjesë përbërëse e dosjes së vlerësimit të gjyqtarit dhe është e përdorshme vetëm në rastin e vlerësimit profesional dhe etik të tij. Çështja civile e verifikuar do të jetë objekt vlerësimi nga ana e Inspektoriatit të KLD-së, mbi bazën e Vendimit nr. 261/2 date 14.04.2010, kur të kryhet vlerësimi i këtij gjyqtari për vitet 2011-2013, dhe për rrjedhojë edhe akti “Tërheqje vëmendje” bëhet i përdorshëm vetëm në momentin kur të përlshihet në aktin e vlerësimit profesional të gjyqtarit për këto vite. Për rrjedhojë, në kohën e ngritjes së padisë, “Tërheqja me shkrim e vëmendjes” nuk ka sjellë asnjë pasojë dhe për rrjedhojë nuk ka shkelur asnjë interes të paditësit Altin Shkurti, në mënyrë që gjykata potencialisht të mund ta rivendosë paditësin në të drejtat e cënuara apo të shkelura. Në këtë kuptim paditësit Altin Shkurti, i mungon interesi aktual dhe i ligjshëm i ngritjes së padisë, dhe për këtë shkak bazuar në nenin 15 shkronja “a” të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, në lidhje me nenin 53, germa “c” të këtij ligji.

⁴ Neni 16/1 i Ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” i ndryshuar dhe neni 25.1 i Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të miratuar me vendimin e KLD-së nr.195/2/a datë 05.07.2006 shtuar dhe ndryshuar me vendimin e KLD-së nr.207/1, datë 07.02.2007.

⁵ Neni 14/4 e Ligjit nr. 8811 date 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” i ndryshuar.

Gjykata Administrativ e e Apelit çmon se vendimi i Gjykatës së Shkallës së parë duhet prishur dhe çështja duhet pushuar pasi paditësi ka ngritur një padi që nuk mund të ngrihej.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 53, germa “c” e ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar

VENDOSI :

- Prishjen e vendimit nr.911 datë 07.03.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e çështjes.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs brenda 30 ditëve në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. afat që fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

U shpall në Tiranë, më 19.01.2015.

ANËTARE
Alkelina GAZIDEDJA
(mendim paralel)

dy

ANËTARE
Blerona HASA

dy

KRYESUESE
Altina NASUFI

dy

Vertetohet njesia me origjinalin

Kancelari

Leonard Strataj

